# DËSHMI ARKIVI

**A-447729**

VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Rama në ceremoninë e hapjes së Konsullatës Shqiptare në Napoli: Italia është 'alter egoja' jonë evropiane - Euronews Albania |
| ADRESA | `https://euronews.al/rama-ne-ceremonine-e-hapjes-se-konsullates-shqiptare-ne-napoli-italia-eshte-alter-egoja-jone-evropiane/` |
| BURIMI | euronews.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 16 shtator 2026, 06:42:15 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 16 shtator 2026, 06:37:35 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `48f968536d0ed939d8e5ea6e46b720bf5672fa70bc7980b6c9b970fb56c2e1bd` |
| TEKSTI | `1e3fea9634be0f7d1088e76c28cc681523d9cdd719ee42400f6fce10099442d6` |
| PAMJA | `efa19889d38ad3242d207d4ef8fb11b30621f936cbcda24469b1fa2fcfbfc12b` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `9cfef8c5c27e84caf5f58d2e8331e9717b7d3433767cf82a66768486fe1e0329` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `985910a8b149f05aa8f3bf8ae89976932fafb83b0b40b51f12f3baea4334fc12` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/9cfef8c5c27e84caf5f58d2e8331e9717b7d3433767cf82a66768486fe1e0329`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

AKTUALITET | POLITIKË

# Rama në ceremoninë e hapjes së Konsullatës Shqiptare në Napoli: Italia është ‘alter egoja’ jonë evropiane

16 Shtator 2026 | 08:37

SHPËRNDAJE ARTIKULLIN

Kryeministri Edi Rama mori pjesë ditën e djeshme në ceremoninë e hapjes së Konsullatës së re Shqiptare në Napoli. Gjatë këtij aktiviteti, ai e vlerësoi përfaqësinë e re si një derë të hapur mes dy realiteteve me afërsi të jashtëzakonshme historike dhe njerëzore.

Në fjalën e tij, Rama e cilësoi Italinë si “alter egoja evropiane“ të Shqipërisë, duke theksuar partneritetin e thellë strategjik mes dy vendeve. Ai u shpreh gjithashtu se shqiptarët janë “napolitanët e anës tjetër të detit” dhe shprehu kënaqësinë për valëvitjen e flamurit shqiptar krah atij italian.

“Sot jemi këtu jo për të hapur një konsullatë në kuptimin e ngushtë të fjalës, por për të hapur një derë mes dy realiteteve që historikisht kanë qenë shumë pranë dhe që, njerëzisht, janë shumë, shumë të ngjashme.

Mes Shqipërisë dhe Italisë ekziston tashmë një partneritet strategjik, solid dhe i thellë, por unë e urrej kur më shkruajnë në fjalimet e mia se Italia është një nga partnerët tanë kryesorë ekonomikë, politikë dhe europianë, sepse kjo vlen për shumë vende të tjera.

Italia nuk është ajo. Italia është alter egoja jonë europiane.

Dhe Napoli është pasqyra jonë nga kjo anë e detit, sepse ne jemi napolitanët e anës tjetër dhe jemi krenarë që jemi të tillë dhe nuk duam të bëhemi milanezë, për të thënë.

Unë jam këtu shumë i lumtur që po e jetoj këtë moment gëzimi, këtë moment ku, edhe pse nuk po, le të themi, shpallim Republikën Shqiptare të Napolit, por gjithsesi kemi hapur së bashku një derë ku është flamuri i Shqipërisë dhe unë jam gjithmonë i lumtur kur e shoh pranë flamurit italian”, është shprehur Rama.

LAJMI I FUNDIT

08:34 **Pritet vendimi për ish-krerët e UÇK, mbështetës dhe familjarë mblidhen para Gjykatës Speciale**

08:23 **Lionel Messi thirret nga Argjentina për të bërë paraqitjen e lamtumirës në miqësoren kundër Benin**

08:23 **Arabia Saudite shkatërron dronin e rebelëve Huthi pranë Mekës**

08:15 **Tre të vdekur nga rrëzimi i helikopterit të NBC-së gjatë raportimit live në Los Angeles (VIDEO)**

08:12 **Drejtori ekzekutiv i Anthropic ripërsërit thirrjen për ngadalësim të IA-së, Nvidia kërkon përshpejtim**

08:04 **“Unë s’jam e lirë, pa lirinë tënde, gjysh” , mbesa e vogël puth portretin e Jakup Krasniqit para vendimit në Hagë**

TESTIM

Shiko në:

## LAJME TË SUGJERUARA

AKTUALITET | KOSOVË | LAJM KRYESOR

**‘Ish-krerët e UÇK-së meritojnë pafajësinë’, Berisha: Nesër, sytë e shqiptarëve drejt Hagës**

Kryetari i Partisë Demokratike, Sali Berisha ka reaguar në prag të vendimit të Gjykatës Speciale në Hagë për ish-krerët e UÇK-së. Berisha shprehet se pret...

22:06 | 15/09/2026

AKTUALITET | KOSOVË

**“Policia masa për të ndaluar grumbullimet para gjykatës”, gazetarja e Euronews raporton nga Haga**

Qytetarë shqiptarë nga Kosova, Shqipëria, vende të ndryshme të Evropës, si dhe nga diaspora më e gjerë, janë mbledhur në Hagë në pritje të vendimit...

20:15 | 15/09/2026

AKTUALITET

**Aksident në aksin Lezhë-Shkodër, përplasen 2 automjete (VIDEO)**

Një aksident rrugor është regjistruar të martën pranë kryqëzimit të Gocajve, në aksin Lezhë-Shkodër. Mësohet se në aksident janë përfshirë 2 automjete, ndërsa si pasojë...

17:31 | 15/09/2026



Copyright © Euronews 2026

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.